



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>20/OPK</u>	Nr. Prot. <u>01-1183/14</u>
Br. Prot. <u>03</u>	Prot No. <u>31.03.2014</u>
Nr. i faq. <u>03</u>	Data <u>31.03.2014</u>
Broj stranica <u>03</u>	Datum <u>31.03.2014</u>
Nr. pages <u>03</u>	Date <u>31.03.2014</u>

DATE/A:	24.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Zejnol Morina, Drejtore i Departamentit të Administratës dhe Shërbimeve Ndihmëse – Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksionit tuaj publik si drejtore i Departamentit të Administratës dhe Shërbimeve Ndihmëse në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i prokurimit në këtë Departament, paraqet mospajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

A r s y e t i m

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Zejnel Morina - Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Shërbimeve Ndihmëse në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, me numër të protokolit 03-671/14, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit të zyrtarit në fjalë, që krahas ushtrimit të funksionit të drejtorit të Departamentit të Administratës dhe Shërbimeve Ndihmëse në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, të ushtroj edhe funksionin të zyrtarit të prokurimit në këtë spital.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Në bazë të këtij ligji pozita juaj si drejtor i Departamentit të Administratës dhe Shërbimeve Ndihmëse në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Pas pranimit të kërkesës suaj, Agjencia ka filluar shqyrtimin e provave dhe fakteve në dispozicion në lidhje me konfliktin e interesit lidhur me këtë rast, dhe vlerëson si në vijim:

Ushtrimi i funksionit të zyrtarit të prokurimit në Departamentin e Administratës dhe Shërbimeve Ndihmëse në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë krahas ushtrimit të funksionit të drejtorit të këtij Departamenti, paraqet mospajtushmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Kjo pasi që pozita e zyrtarit të prokurimit, në bazë të organogramit të këtij spitali, funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës të cilën ju e udhëhiqni. Andaj, bazuar në këtë dhe në përgjigjen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), nuk mund t'i ushtroni njëkohësisht të dy funksionet.

Në bazë të nenit 8 (paragrafi 1) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, zyrtari i lartë ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit, ndërsa bazuar në nenin 7 (paragrafin 8), zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

Andaj, meqenëse ju jeni i vetmi punëtor i licencuar nga KRPP për të udhëhequr procedurat e prokurimit, Drejtori Ekzekutiv mund të emëroj përkohësisht një zyrtar të ushtrojë funksionin e drejtorit të këtij departamenti dhe ju të ushtroni funksionin e zyrtarit të prokurimit. Kjo bazuar në atë se, më herët keni deklaruar se nuk keni mundur të arrini marrëveshje me ndonjë autoritetet tjetër kontraktues për caktimin e një zyrtari të prokurimit, ashtu siç parashihet me nenin 23 (paragrafi 3) të Ligjit për Prokurimin Publik.



Andaj, konform asaj që u tha më lartë, iu rekomandojmë që të veproni konform këtij opinioni, që të parandaloni konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt!

* 04050 *